

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësoredhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Nebojša Boričić, anëtarë me bashkëpunëtor profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **Palës ankuese** :

**F. S.**, Rr. “...” Nr. ... , Viti

**Kundër:**

**D. A.**, Republika e Serbisë

***Pala përgjegjëse - Paraqitesi i Kërkesës KPA...***

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës( më tutje KKPK) nr. KPCC/D/A/100/2011 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave (më tej AKP) me numër KPA37673), të datës 23 Shkurt 2011 pas shqyrtimit të mbajtur më 21 Mars 2019 mori këtë:

### **AKTGJYKIM**

Ankesa e paraqitur nga **F. S.**, kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës **KPCC/D/A/100/2011** (për sa i përket lëndës së regjistruar në **AKP** me numrin **KPA...**) të datës 23 Shkurt 2011, hidhet poshtë si e papranueshme për shkak se pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën e shkallës së parë (Neni 10.2 i Ligjit nr.03/L-079).

#### **Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 5 Nëntor 2007, **D. A.** (më tej: pala përgjegjëse në ankesë) duke vepruar si bartësit i pretenduar i të drejtës pronësore, ka paraqitur një kërkesë në **AKP** duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në 1/3 dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale ..., që ndodhet në Viti , në vendin e quajtur “Bejram” me kulturë arë e klasit të I-rë me sipërfaqe prej 0.11.33 h(më tej: prona e kërkuar). Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se është bashkëpronar në pjesën ideale 1/3 i pronës së kërkuar dhe ai e kishte trashëguar 1/3 e pronës bashk me vellaun **S.** dhe motrën **D.** pas vdekjes së babait të tyre dhe se e kishte humbur posedimin mbi të më 12 Qershor 1999 si rezultat i rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në vitin 1998/1999 në Kosovë.

2. Për ta mbështetur kërkesën, pala përgjegjëse në ankesë dorëzoi në AKP:
  - Kopjen e fletës poseduese nr. ... datë 28 Maj 2004 lëshuar nga Drejtoria Komunale e Gjeodezisë në Viti ku ngastra ..., evidentohet si bashkepronësi nga 1/3 e palës përgjegjëse.
  - Letërnjoftim i lëshuar me 24 Maj 2006 nga komuna paralelel e Vitisë .
3. Më 19 Korrik 2008 AKP-ja e vendosi shenjën në pronën e kërkuar dhe më pas më 30 Korrik 2010 Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e bëri njoftimin e kërkesës në Gazetën e Njoftimeve Nr. 6 dhe në Buletinin e UNHCR-së duke e shperndarë noftimin tek lideri i fshatit F.E., Komuna e Vitisë, Gjykata Komunale Viti, Zyrat Rajonale të AKP-së dhe UNHCR-së në Gjilan dhe në zyrën e Ombudspersonit. Prona ishte gjetur tokë e pakultivuar dhe askush nuk është paraqitur për të shfaqur interes ligjor për pronën e kërkuar.
4. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 11 shtator 2008 fleta poseduese e prezantur nga pala përgjegjëse në ankesë është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së dhe se ishte gjetur ne zyrën kadastrale në Viti.
5. Më 23 Tetor 2008, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/25/2008 vendosi se pala përgjegjëse në ankesë kishte vërtetuar se ishte pronari i 1/3 i pronës së kërkuar dhe se pala përgjegjëse në ankesë kishte të drejtën e posedimit të pronës në fjalë duke nxjerr urdher debimi për personat eventuasl qe gjenden nëpronë.
6. Me 24 Shkurt 2010 me Rezolutën e vet KPCC/RES/16/2010 KPCC/D/A/25/2008 të datës 23 Tetor 2008 dhe ktheu lëndën në Sekretariat për shkak te mangesive në notifikimin e pronës.
7. Me 30 Korrik 2010 u bë rinotifikimi pronës së kërkuar dhe nuk gjet ndonje ndryshim në pronën e kërkuar.
8. Me 23 Shkurt 2011 KKPK-ja me vendimin e vet KPCC/D/A/100/2011 vendosi që Pala përgjegjse D. A., ka deshmuar se është pronar i 1/3 i pronës së kërkuar dhe se pala përgjegjëse në ankesë kishte të drejtën e posedimit të pronës në fjalë duke nxjerr urdher debimi për personat eventuasl qe gjenden nëpronë
9. Vendimi iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 27 Qershor 2011. Me 25 Korrik 2011 pala përgjegjëse në ankesë kishte bërë kërkesë për administrimin e pronës nga ana e AKP-së në kuptim të nenit 17 të Ligjit nr.03/L-079 dhe se pala përgjegjëse në ankesë kishte të drejtën e posedimit të pronës në fjalë duke nxjerr urdhër debimi për personat eventual që gjenden në pronë dhe rasti ishte mbyllur me aprovimin e administrimit me 25 Tetor 2011.

10. Pala përgjegjëse në ankesë kishte bërë kërkesë për kthimin e posedimit pas administrimit me 15 Shtator 2014. Në procedurën e shkallës së parë askush nuk kishte mar pjesë dhe nuk e kishte kundërshtuar kërkesën e palës për kthimin e pronës. F. S., si palë e interesuar i ka paraqitur Sekretarisë ekzekutive interesin ligjor lidhur me pronën e kërkuar e kishte pranuar Vendimine KKPK-së me 28 Janar 2015 dhe kishte paraqitur ankesë me 26 shkurt 2015.

#### **Pretendimet e palës ankuese:**

11. Pala ankuese pretendon se Vendimi i KKPK-së përmban gabime thelbësore apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, dhe bazohet në vërtetim të gabueshëm apo të mangët të gjendjes faktike.
12. Pala ankuese pretendon se prona e kërkuar është dhene ne shfrytëzim me qira nga pala përgjegjëse dhe se ai për shfrytëzim të pronës paguan qira mbi bazën vjetore.
13. Për ta mbështetur ankesën e tij, pala ankuese dorëzoi në Gjykatën Supreme
- Një Kontratë joformale për shfrytëzim të tokës bujqësore ku caktohej çmimi vjetor i qirasë dhe ishte nënshkruar nga pala ankuese dhe pala përgjegjëse;
  - Dëshmi se për vitet 2013 deri 2015 ai ka paguar dhe pala ankuese i ka pranuar çmimin e qirasë;
14. Mbi bazën e këtyre ai propozon Gjykatës Supreme që kërkesën e palës përgjegjëse ta hedh ose ta kthej çështjen në rishqyrtim. Nuk ka paraqitur asnjë provë e as që ka pretenduar të vë në pyetje të drejtën pronësore të palës përgjegjëse.

#### **Arsyetimi ligjor**

##### *Pranueshmëria e ankesës*

15. Ankesa është e papranueshme sepse është paraqitur nga një person që nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë para KKPK-së.
16. Në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr.03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës rreth Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.
17. Neni 10.1 i Ligjit nr.03/L-079 parashih se pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive njofton dhe dërgon një kopje të kërkesës çdo personi përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës. Neni 10.2 i ligjit të njëjtë parashih se *“Çdo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës dhe/ose ndonjë person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronën e kërkuar do të jetë palë ... , me kusht që ai person e informon Sekretarinë*

Ekzekutive për qëllimin e tij/saj që të merr pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive [...]”.

18. Vetëm pala në procedurë në shkallën e parë ka të drejtë që të paraqet ankesë kundër Vendimit të KKKPK-së. Bazuar në praktikën e Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme, përjashtimi i vetëm ndaj këtij rregulli paraqitet nëse personi i cili mund të kërkojë një të drejtë mbi pronën e kontestuar nuk ka pasur njohuri se kërkesa ishte paraqitur në AKP për shkak të njoftimit të gabueshëm dhe prandaj ai/a jo nuk është në gjendje ta paraqet njoftimin e pjesëmarrjes gjatë procedurës në shkallën e parë.
19. Në rastin në fjalë, Gjykata Supreme është e mendimit se pala ankuese ka qenë në dijeni për procedurën në lëndën KPA..., ngase prona është vizitur në Korrik të vitit 2008 (pronat bujqesore vizitohen në Qershor për hak të marrjes së fryteve të tokës) dhe është gjetur toke e pa punuar -livadh. Sekretaria kishte publikuar kërkesën në Korrik të vitit 2010 në të gjitha vendet e frekuentimeve të mundshme dhe se njoftimi ishte bërë në përputhje me Nenin 10.2 të Ligjit nr.03/L-079 dhe që nga vitit 2008 deri në marrjen e vendimit të Komisionit pala ankuese nuk kishte shfaqur interes për pronën e kërkuar.
20. Edhe pas venjes në administrim të pronës nga AKP-ja nuk ka pas reagim nga asnjë palë. Vetëm pas kërkesës për riposidim që ishte e drejtë e titullarit ta kërkojë në çdo kohë pas administrimit të pronës mbi bazën e vendimit të KKKPK-së, pala ankuese shfaqti interes ligjor duke pretenduar shfrytëzimin me qira.
21. Shfrytëzimi me qira i pronës qoftë edhe mbi bazën e vullnetit të pronarit nuk është pengesë për marrjen në posedim të palujtshmerisë në kohën e përshtshme për pronarin dhe nuk krijon raport pronësor-juridik me shfrytëzuesin.
22. Gjykata Supreme vëren se në bazë të fakteve të lartcekura, pala ankuese i ka pasur të gjitha mundësitë që të jetë në dijeni për procedurën që po zhvillohej në shkallën e parë, duke pasur parasysh se njoftimi ishte kryer si duhet duke i vendosur shenjat përkatëse të ngastra e cekur.
23. As në shkallën e parë e as me ankesë nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vënte në dyshim të drejtën pronësore të palës përgjegjëse.
24. Ankesa duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 12.1 dhe 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1, nën-paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Prandaj, Kolegji vendosi sikurse në dispozitiv.
25. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese që ta kërkojë të drejtën e saj para gjykatës kompetente nëse e konsideron të domosdoshme.

**Këshillë ligjore:**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr.03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NE PRISHTINE**

**GSK-KPA-A-001-2016 me datën 21 Mars 2019**

**Bashkp. Profesional**

**Sherif Krasniqi**

**KRYETARI I KOLEGJIT**

**Beshir Islami**